



GVT/COM/INF/OP/I(2003)004
Albanian version

**ADVISORY COMMITTEE ON THE FRAMEWORK CONVENTION
FOR THE PROTECTION OF NATIONAL MINORITIES**

COMMENTS

KOMENTET E QEVERISË SHQIPTARE MBI “OPINIONIN” E KOMITETIT KËSHILLUES TË “KONVENTËS KUADËR PËR MBROJTJEN E PAKICAVE KOMBËTARE”.

HYRJJE

Në datën 26.07.2001, Shqipëria ka paraqitur pranë Këshillit të Evropës Raportin e parë “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave Kombëtare”. Nga datat 9 Prill deri 3 Maj 2002, Komiteti Këshillues i “Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare” të Këshillit të Evropës, ka vizituar Shqipërinë në kuadër të ekzaminimit të këtij raporti, si dhe për të marrë informacion të mëtejshëm mbi zbatimin e kësaj Konvente.

Në datën 12.09.2002 Komiteti Këshillues i “Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare” të Këshillit të Evropës, ka miratuar “Opinionin” lidhur me Raportin e paraqitur nga Shqipëria.

Duke vlerësuar rëndësinë e “Opinionit” të Komitetit Këshillues, ky dokument iu dërgua për mendim disa institucioneve qendrore, brënda të cilëve janë të përfshira struktura që trajtojnë problemet e pakicave kombëtare. Gjithashtu, ky opinion iu dërgua dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, Akademisë së Shkencave, Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, si dhe shoqatave të ndryshme të pakicave kombëtare dhe gjuhësore. Kështu që këto komente janë rezultat i dialogut dhe konsultimeve midis të gjitha palëve të interesuara. Zyra e Minoriteteve në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në kuadrin e rritjes së mëtejshme të frymës së dialogut dhe të transparencës si dhe në bazë të sugjerimeve të bëra nga Komiteti Këshillues mori iniciativën e përkthimit të këtij dokumenti në gjuhët e pakicave kombëtare (greqisht, serbo-kroatisht dhe maqedonisht) duke mundësuar kështu informimin e pakicave lidhur me Opinionin.

Bazuar edhe në mendimet dhe vërejtjet e institucioneve të sipërmendura, Qeveria e Republikës së Shqipërisë paraqet komentet e saj si më poshtë vijon:

KOMENTE LIDHUR ME PËRMBLEDHJEN EKZEKUTIVE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë vlerëson punën e Komitetit Këshillues në procesin e monitorimit dhe zbatimit të Konventës Kuadër dhe vëren se komentet e Komitetit Këshillues përveç një pune tepër të kujdesshme dhe profesionale tregojnë gjithashtu dhe një vëmendje e përkujdesje sistematike ndaj problemeve më shqetësuese të pakicave kombëtare që jetojnë në Republikën e Shqipërisë.

Republika e Shqipërisë e konsideron respektimin e dispozitave të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, jo vetëm si një detyrim që buron nga zbatimi i normave të legjislacionit të brendshëm, por edhe si një nga angazhimet më të rëndësishme të ndërmarra në kuadrin e procesit të Stabilizim-Asociimit në Bashkimin Evropian.

Komentet e mëposhtme janë rezultat i dialogut dhe konsultimeve midis të gjitha palëve dhe strukturave, të cilat trajtojnë problemet e pakicave. Autoritetet shqiptare

janë të mendimit që përgjithësisht në këtë relacion ngrihen disa probleme që duhet të merren parasysh me qëllim që të plotësohet dhe të rregullohet legjislacioni ekzistues që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ka të bëjë me pakicat dhe njëkohësisht të përmirësohet gjendja e tyre aktuale. Por nga ana tjetër vihet re se metoda e ndjekur për hartimin e Opinioneve të krijuar përshtypjen se në nxjerrjen e konkluzioneve të tij, Komiteti Këshillues është bazuar në disa versione verbale të pretendimeve për shkelle të drejtave të personave të pakicave të padokumentuara, vërtetësia e të cilave është shumë e vështirë për t'u provuar, duke krijuar kështu një tablo që është larg realitetit të respektimit të të drejtave të pakicave. Legjislacioni shqiptar duke filluar me Kushtetutën e Shqipërisë dhe aktet e tjera ligjore, i bëjnë një jehonë të plotë dhe të saktë frymës së Konventës Kuadër për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Kjo arritje e shoqërisë shqiptare është konsoliduar gjatë viteve, sidomos gjatë periudhës së transformimeve demokratike. Padyshim shoqëria shqiptare përballet me vështirësi dhe sfida serioze, por përse i përket gjëndjes së pakicave kombëtare, për nga toleranca, bashkëjetesa normale, fqinjësia e mirë, kjo mund të shërbejë si model për gjithë hapësirën ballkanike.

Duke pasur parasysh komentet e Komitetit Këshillues, mbi plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional Qeveria e Republikës së Shqipërisë pranon se duhet bërë më tepër për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, i cili ka të bëjë me pakicat, veçanërisht në marrëdhëniet me autoritetet administrative, përdorimin e emrave tradicionale, emrave të rrugëve si dhe treguesve të tjerë topografikë. Për të qënë më konkret vlen të përmendim faktin se është ngritur grupi i punës *ad hoc* për rishikimin e legjislacionit, i cili shumë shpejt do dalë me konkluzione përfundimtare lidhur me përmirësimin e legjislacionit aktual gjithmonë konform parimeve të Konventës Kuadër.

Gjithashtu, në Kuadrin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, me asistencën zvicerane, është filluar puna nga një grup ekspertësh të pavarur për projektin Non-Discrimination Review, i cili do të zgjasë deri në Qershor 2003. Gjashtë nga nëntë shtetet pjesëmarrëse në këtë projekt, midis të cilëve dhe Shqipëria kanë paraqitur raportin paraprak vlerësues.

Lidhur me mungesën e të dhënave statistikore për pakicat si dhe me komentin për mosegzistencën e rubrikës së kombësisë në regjistrimin e popullsisë dhe të banesave, të vitit 2001, sqarojmë se vërtet ne përse i përket të dhënave i referohemi censusit të vitit 1989, i financuar nga OKB-ja. Gjithashtu, pranohet se në regjistrimin e fundit të popullsisë dhe banesave, (REPOBA 2001), nuk u përfshi rubrika e kombësisë për shkaqe teknike dhe jo politike, arsye të cilat janë mirëpritur edhe nga donatorët e këtij regjistrimi, si Komisioni Evropian, Qeveria Greke. Po në këtë kuadër duke vlerësuar rëndësinë e të dhënave të azhornuara mbi pakicat, gjatë vitit 2002, si pjesë e programit të Qeverisë për strategjinë kombëtare për zhvillim ekonomik dhe social, INSTAT i asistuar nga Banka Botërore organizoi anketën LSMS (Living Standard Measurement Survey). Megjithëse fokusi i kësaj ankete ishte grumbullimi i informacionit mbi nivelin e jetesës dhe varfërisë të familjeve dhe individëve, në grupin e pyetjeve identifikuese u përfshi dhe ajo mbi kombësinë. Të dhënat e kësaj ankete shumë shpejt do të bëhen

publike. Përsa i përket problemit të statusit të egjiptianëve, diskriminimit ndaj romëve si dhe pjesëmarrjes efektive të pakicave në jetën ekonomike dhe politike të vendit, për të evituar përsëritjejt mendojmë që të shqyrtohen në mënyrë të detajuar në komentet për paragrafet respektive.

II. SHËNIME TË PËRGJITHSHME

Qeveria Shqiptare vlerëson faktin që në ekzaminimin e zbatimit të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, nga Shqipëria Komiteti Këshillues ka marrë parasysh vështirësitë ekonomike, sociale si dhe konsideratat e bëra lidhur me përpjekjet për zbatimin e Konventës Kuadër.

Lidhur me vërejtjen se për hartimin e raportit nuk është bërë një konsultim i gjerë me përfaqësuesit e pakicave kombëtare, vlen fillimisht të theksojmë se afati i caktuar për hartimin e Raportit ishte i shkurtër për të përmbushur një proces të tillë konsultimi, i cili kërkon një shumëllojshmëri informacioni lidhur me gjëndjen aktuale të pakicave dhe si pasojë një kohë të konsiderueshme. Gjithashtu, në kuadrin e rritjes së bashkëpunimit me pakicat, autoritetet shtetërore, ndërmorën iniciativën e përkthimit të “Opinionit”, në gjuhët e pakicave kombëtare (greqisht, maqedonisht, serbo-kroatisht). Ndërsa shoqatave rome dhe arumune, dokumenti i është vënë në dispozicion në gjuhën shqipe. Kjo iniciativë tregon më së miri qëndrimin e Qeverisë Shqiptare ndaj pakicave, si partnere në ndërtimin e politikave.

Përsa i përket bashkëpunimit me Organizatat Joqeveritare përmendim organizimin e një sërë seminaresh për rritjen e ndërgjegjësimit mbi Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe mbi gjetjen e zgjidhjeve të mundshme të problemeve që shqetësojnë pakicat, ku Zyra e Minoriteteve ka qënë gjithmonë e ftuar, gjë që tregon që Qeveria shqiptare i konsideron OJQ-të si bashkëpunëtorë të denjë në promovimin e vlerave të një shoqërie demokratike. Gjithashtu, në përbërjen strukturore të institucionit të Avokatit të Popullit, përfshihet një Seksion i Përgjithshëm për bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe për studimin e veprimtarisë në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut, gjë që shpreh rëndësinë e bashkëpunimit me OJQ-të.

Pjesëmarrja aktive e Republikës së Shqipërisë në Projektin Link Diversity, të iniciuar në kuadrin e Paktit të Stabilitetit, është një dëshmi e përpjekjeve gjithnjë e në rritje për promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit, për krijimin e një shoqërie shumë-kulturore.

Lidhur me pretendimin se ka “zëra”, që Qeveria nuk i përgjigjet disa ankesave të bëra nga personat që i përkasin pakicave, mendojmë se në hartimin e këtij opinionit si dhe në konkluzionet e tij, Komiteti Këshillues nuk duhej të bazohej në kontakte verbale me individë, te cilat nuk mund të ballafaqohen apo vërtetohen.

Për të qënë sa më efektive dhe për të ndihmuar në zgjidhjen e këtyre problemeve, është e rëndësishme paraqitja e problemeve konkrete që shqetësojnë pakicat, si dhe një bashkëpunim më i madh me Zyrën e Minoriteteve, në mënyrë që të bëhet një

koordinim më i mirë i punës midis institucioneve përgjegjëse për trajtimin e problemeve të pakicave. Gjithashtu në këtë pikë theksojmë veprimtarinë e Avokatit të Popullit, për ndërgjegjësimin e opinionit publik, mbi funksionimin e këtij institucioni në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të të gjithë individëve, grupeve të individëve, apo organizatave joqeveritare. Po kështu ligji “Mbi të drejtën e informimit e përcakton këtë institucion “si kujdestar” për përmbushjen e përcaktimeve të tij, nga administrata publike.

Përsa i përket komenteve të Komitetit Këshillues lidhur me pretendimet mbi numrin zyrtarisht të pranuar të pakicave kombëtare, i cili varion nga 2%, sipas burimeve qeveritare deri në 20% sipas “burimeve të tjera”, theksojmë se Qeveria Shqiptare duhet të jetë shumë e kujdesshme për këtë çështje dhe ftojme dhe Institucionet e ndryshme ndërkombëtare të bëjnë të njëjtën gjë duke u mbështetur vetëm në të dhëna dhe burime zyrtare të besueshme..

Ndërsa lidhur me sugjerimin e Komiteti Këshillues për interpretimin e rezultateve në përputhje me zgjedhjen subjektive të personit përsa i përket organizimit brënda një grupi të caktuar nënvizojmë se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 20 në përputhje nenin 3 të Konventës Kuadër sanksionon të drejtën e çdo personi për të shprehur lirisht identitetin e vet etnik, por kjo liri nuk mund të jetë vetëm subjektive jashtë çdo konsiderate tjetër. Kjo përcaktohet qartë edhe në komentarin për dispozitat e Konventës Kuadër, sipas të cilit zgjidhja subjektive është pandarshmërisht e lidhur ngushtë me disa kriteret objektive përkatëse të identitetit të personit.

Në Opinion në mënyrë të njëanshme vihet theksi te zgjidhja subjektive pa përmendur fare kriteret objektive për të cilat bën fjalë Komentari për Konventën Kuadër. Si në teori edhe në praktikë nuk është e lehtë të përcaktohen këto kriteret objektive, aq më tepër duke pasur parasysh vështirësitë në vetë përcaktimin e nocionit të minoriteteve. (Protokollin shtesë i Konventës Evropiane i Këshillit të Evropës i cili nuk u miratua nga Komiteti i Ministrave).

Një ndër kriteret për të përcaktuar një “pakicë kombëtare” është edhe ai që personat përkatës të shfaqin karakteristika etnike, kulturore fetare dhe gjuhësore të veçanta nga pjesa tjetër e popullsisë. Ky kriter duhet të mbahet parasysh në përcaktimin e kombësisë ose përkatësisë etnike të një individi, për të mos absolutizuar kriterin subjektiv, d.m.th. “zgjedhjen personale”. Ndryshe nga përkatësia në një komunitet fetar e cila ka thjesht karakter subjektiv pasi nënkupton të drejtën e çdo individi të besojë ose jo dhe të ndryshojë përkatësinë fetare, përkatësia kombëtare ose etnike si-u tha më sipër nuk ka vetëm karakter subjektiv, por bazohet edhe në kriteret objektive. Për këtë iu referohemi dhe gjithë konventave ndërkombëtare të Këshillit të Evropës, O.K.B-së dhe O.S.B.E.-së.

Në “Opinion” janë lënë mënjanë kriteret objektive si p.sh gjuha e folur në familje, kombësia, traditat. Në kushtet që kalon Shqipëria, mospërfillja e kriterit objektiv, pra lidhja e qëndrueshme me vendin, por vetëm marrja parasysh e kriterit subjektiv, që është shprehja e vullnetit për të qënë veçmas një pakicë do të çonte në një fryrje

artificiale të popullsisë minoritare, si dhe të instrumentalizimit të rrezikshëm politik të pakicave.

III. KOMENTE TË VEÇANTA LIDHUR ME NENET 1-19:

NENI 1.

Shqipëria është palë në pesë Konventat Kryesore të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, të cilat i referohen ndër të tjera edhe diskriminimit. Këto konventa janë: “Pakti për të drejtat civile dhe politike” “Pakti për të drejtat ekonomiko-sociale dhe kulturore”, Konventa “Për ndalimin dhe diskriminimin racial”, Konventa “Për ndalimin e diskriminimit ndaj gruas”, Konventa “Për të drejtat e fëmijës”.

NENI 3 Paragrafët 17-20

Përsa i përket zgjerimit të fushës së zbatimit të Konventës Kuadër, si dhe çështjes së riekzaminimit të njohjes së romëve dhe arumunëve si pakicë kombëtare fillimisht vëmë në dukje se statusi i pakicës gjuhësore apo kombëtare nuk ka ndonjë efekt negativ apo diskriminues mbi zbatimin e dispozitave të Konventës Kuadër. Njohja e statusit të pakicës linguistike këtyre grupeve bazohet në faktin se vlllehët sikurse edhe romët, nuk kanë një shtet amë.

Në situatën ligjore ku përkufizimi i pakicës kombëtare mungon, Shqipëria procesin e njohjes së pakicave kombëtare e bazon në kriteret e e përcaktuara nga Konventat Ndërkombëtare duke respektuar si faktorin objektiv ashtu edhe atë subjektiv.

Në rastin e arumunëve (vlllehëve), mund të themi se mungon deri diku faktori subjektiv. Megjithëse nuk mund të mohohet se ka një pakicë vlllehe, i cili ruan e kultivon tiparet e veta që e pasurojnë jetën shoqërore dhe kulturore, shumica e tyre në vendin tonë nuk e dallojnë më veten e tyre nga pjesa tjetër e popullsisë. Pjesa më e madhe e tyre nuk e flasin dhe nuk e kuptojnë të folurën vlllehe dhe as nuk e shtrojnë çështjen e trajtimit të tyre si pakicë kombëtare.

Ata janë integruar në një shkallë të tillë në jetën e vendit sa që mund të thuhet se vështirë mund të dallohet kufiri ndarës, me shumicën e popullsisë. Integrimi i tyre në gjirin e shoqërisë shqiptare ka arritur një shkallë të tillë, sa që nuk mund të trajtohet si pakicë, por si pjesë përbërëse e popullsisë. Fenomeni arumun nuk është thjesht shqiptar, por në të gjithë Ballkanin ka kudo vlllehë të cilët, ndërsa ruajnë gjuhën dhe traditat e tyre janë shkrirë me popullsinë vendase. . Përveç kësaj, në shumë vende njihet nocioni i komuniteteve ose pakicave gjuhësore, i ndryshëm nga ai kombëtar (p.sh. arbëreshët në Itali, megjithëse kanë shtetin e tyre mëmë, njihen si pakicë gjuhësore).

Qeveria shqiptare paraqet kështu rezerva përsa i përket sugjerimit për rishikimin e statusit të pakicës gjuhësore vlllehe duke u mbështetur vetëm në “pakënaqësinë e disa personave” dhe mirëpret çdo lloj sugjerimi apo kritika konstruktive lidhur me këtë çështje.

Lidhur me pikën 21 dhe 22 të “Opinionit”, ku sugjerohet, që të rikonsiderohet mundësia e njohjes së komunitetit “ egjiptian” si pakicë kombëtare, edhe njëherë vihet re tendenca për të përkufizuar pakicat kombëtare duke u bazuar vetëm në faktorin e zgjedhjes subjektive. Përgjithësisht mendojmë se ka një njohje të pakët të problemit të të vetëquajturve egjiptianë. Në këtë rast termi egjiptian është pavend, pavarësisht se drejtuesit e shoqatës përkatëse e përdorin këtë term që prej viteve `90. Qeveria egjiptiane nëpërmjet Ambasadës së saj në Tiranë ka deklaruar se ky komunitet nuk ka lidhje etnike me egjiptianët, si dhe ka lëshuar një deklaratë nëpërmjet së cilës bën të ditur se nuk njih asnjë pakicë egjiptiane në Shqipëri. Në kontaktet me përfaqësinë egjiptiane në Tiranë asnjëherë nuk është ngritur si çështje për diskutim çështja e njohjes së komunitetit egjiptian.

Historikisht jevgjit ose evgjitët kanë ardhur në Ballkan dhe në Shqipëri nga India nëpërmjet Egjiptit dhe kjo është e vetmja lidhje me këtë vend. Ndryshe nga romët që kanë karakteristika etnike, kanë qënë nomad dhe kanë gjuhën e vet, jevgjit janë sedentarë, të përhapur në shumë zona të Shqipërisë dhe jo vetëm në një zonë të veçantë. Në gjuhën e vendit ata quhen “jev gj” ose “ev gjitë” dhe origjina e tyre është e diskutueshme. Ata nuk kanë gjuhë të vetën dhe flasin gjuhën shqipe. Ata janë integruar plotësisht në shoqërinë shqiptare dhe dallimi i tyre nga shqiptarët e tjerë është dallimi racor, si ngjyra e lëkurës etj. Edhe njëherë shprehim mendimin se çështja e njohjes së statusit të pakicës kombëtare jevgjitëve (egjiptianëve) nuk do të ishte e bazuar në ata elementë subjektiv dhe objektiv, të pranuar edhe nga Këshilli i Evropës për njohjen e statusit pakicave kombëtare.

Lidhur me paragrafin 23 të nenit 3, ku shprehen dyshime ndaj informacioneve të dhëna nga qeveria shqiptare dhe shtrohet çështja se në Shqipëri ka edhe grupe të tjera etnike ose gjuhësore të cilat ende nuk janë konsideruar si pakica kombëtare nënvizojmë se deri tani nuk ka të dhëna për egzistencën si dhe kërkesa të bëra nga grupe të tilla dhe nëse Komiteti Këshillues disponon informacion mbi egzistencën e këtyre grupeve në Shqipëri do të ishte e mirëpritur vënia e tyre në dispozicion të autoriteteve shtetërore shqiptare.

Lidhur me paragrafin 24, i cili ngre çështjen e sigurimit të të drejtave “pa kufi” të pakicave kombëtare jashtë zonave tradicionale ku ata jetojnë, të ashtuquajturave “zona minoritare”. Theksojmë se në asnjë akt ligjor të legjislacionit aktual, përmendet termi ‘zonë minoritare’ dhe të drejtat e pakicave kombëtare janë të njohura në të gjithë territorin e Shqipërisë, pa asnjë paragjykim të bazuar në kriterin gjeografik..

Qëndrimi i Qeverisë Shqiptare ka qënë gjithmonë siguri i të drejtave të pakicave si brenda edhe jashtë zonave të origjinës. Deri tani nuk ka asnjë praktikë zyrtare të aplikimit të këtij kriteri, i cili është anti-kushtetues dhe nuk gjen shprehje në sistemin ligjor shqiptar.

NENI 4

Lidhur me paragrafin 25, sipas të cilit në Shqipëri ka hapësira për zgjerimin e kuadrit legjislativ sqarojmë se Kodi Penal ka dispozita që garantojnë barazinë e

shtetasave dhe dënojnë me sanksione të ndryshme penale dhe administrative kryerjen e dallimeve mbi bazë origjine seksi, bindje fetare a politike, ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë të caktuar (neni 253 KP). Po kështu në nenin 265 parashikohet dënimi me gjobë apo me burgim deri në 10 vjet, për nxitjen e urrejtjes ose grindjeve midis kombësive, racave dhe feve. Ndërsa përsa i përket sugjerimit për parashikimin si figurë krimi të veçantë, krimet për motive racore, si dhe marrjen parasysht nga gjykata të motivit racor si rrethanë rënduese do të shihet mundësia e përfshirjes së një neni të tillë në Kodin Penal, por realisht nuk ka raste të përsëritura të këtij fenomeni që do ta bënin imediate parashikimin e kësaj figure krimi.

Lidhur me paragrafin 26, ku sugjerohet mbledhja e të gjithë legjislacionit përkatës në lidhje me anti-diskriminimin, mendojmë se duhet patur parasysht fakti, nëse teknikisht është e mundur përfshirja e normave të ndryshme penale, administrative, në një akt të vetëm legjislativ.

Lidhur me **paragrafin 27**, mbi përgatitjen një ligji specifik për mbrojtjen e pakicave Qeveria Shqiptare shpreh edhe njëherë se respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave garantohet më së miri nga legjislacioni aktual, i cili siç edhe theksuam popërmirësohet dhe plotësohet vazhdimisht. Gjithashtu, gjykojmë se, Konventa Kuadër Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, pas ratifikimit bëhet pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe ka forcën e ligjit, është e mjaftueshme si garanci për mbrojtjen e të drejtave të pakicave në Shqipëri.

Përsa i përket paragrafit 28 dhe 29, sipas të cilit megjithëse pranohet fakti se diskriminimi nuk është një problem madhor në Shqipëri vihet në dukje se Komiteti Këshillues ka dijeni nëpërmjet ankesa nga disa persona të pakicave për diskriminim në fusha të ndryshme, nga papunësia deri te aksesit në shërbimet sociale, Qeveria Shqiptare thekson se në mungesë të rasteve konkrete, është e vështirë të komentohet lidhur me këto ankesa. Probleme të tilla si papunësia, gjëndja e vështirë ekonomiko-sociale, arsimi, strehimi, infrastruktura etj janë probleme që i has gjithë shoqëria shqiptare. Sigurisht, shqetësimet lidhur me diskriminimet në fusha të ndryshme meritojnë vëmendje, dhe nuk mohohet fakti se mund të ketë pasur raste të tilla, megjithatë këto përbëjnë raste të izoluar dhe nuk janë shprehje e një vullneti politik. Autoritetet shqiptare siç përmendet dhe në Opinion ia kanë bërë të qartë eksperteve se këto “diskriminime” kanë karakter të përgjithshëm dhe nuk e kanë bazën tek dallimet etnike, racore dhe fetare, kështu që, përsa i përket pozitës së romëve dhe egjiptianëve mund të themi se ata nuk janë objekt i diskriminimeve si komunitet më vete. Lidhur me këtë pikë Institucioni i Avokatit të Popullit shprehet se ka pasur ankesa me këtë problematikë, por subjektet përkatëse nuk janë paraqitur asnjëherë si përfaqësues të pakicave kombëtare.

Qeveria shqiptare e ndërjegjshme për problemet e shumta ekonomike, sociale në drejtim të strehimit, punësimit, arsimimit, kulturës, infrastrukturës, pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën politiko-shoqërore të pakicës rome ndërmori punën për hartimin e strategjisë kombëtare për “Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së

Romëve”, ndër objektivat e së cilës është lufta kundër diskriminimit të kësaj pjese të popullsisë.

Lidhur me Paragrafin 30 Komiteti shpreh edhe njëherë shqetësimin e tij për diferencën social-ekonomike që po krijohet midis romëve dhe pjesës tjetër të popullsisë shqiptare, përsa i përket arsimimit, strehimit, punësimit etj si dhe mungesa e të dhënave të sakta përbën realisht një pengesë për shtetin në mënyrë që të evidentojë, zbatojë dhe monitorojë masat për të implementimin e Konventës Kuadër. Është e vërtetë që kemi të bëjmë me një shtresë përgjithësisht të varfër, por kjo nuk është e vetmja shtresë e varfër në Shqipëri, për hir të së vërtetës duhet thënë se në këtë gjendje janë edhe shumë shtetas të tjerë, sidomos në zonën verilindore të vendit. Gjendja e ulët ekonomike, arsimore, kulturore, përbën një problem tjetër të rëndësishëm që i bën ata të jenë të emargjinuar dhe të mos kenë faktikisht mundësi të barabarta me shtetasit e tjerë për të marrë pjesë aktive në jetën politike dhe shoqërore. Përsa i përket mungesës së të dhënave të sakta lidhur me ta, duhet të meret parasysh karakteri i jetës nomade të tyre, gjë që vështirëson kryerjen e këtij procesi. Sigurisht zbatimi i strategjisë kombëtare për romët do të ndikojë në zbutjen e diferencave me pjesën tjetër të popullsisë.

Lidhur me paragrafin 31, përsa i përket hartimit të strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të Jetesës së romëve”, Qeveria Shqiptare është angazhuar seriozisht në realizimin e saj. Siç jeni në dijeni, për hartimin e këtij dokumenti është ngritur grupi i punës, nën drejtimin e Zëvendës Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, si dhe ka mbaruar puna për hartimin e Platformës Bazë, e cila i është paraqitur grupit të punës në një nga mbledhjet e tij të rradhës. Për hartimin e kësaj Platforme është studiuar dhe pasqyruar eksperiencia e Rumanisë.

1. Objektivat kryesore të kësaj strategjie janë:

- ? Eliminimi i çdo lloj forme diskriminimi ndaj romëve si dhe inkurajimi i këtij komuniteti për të marrë pjesë në mënyrë aktive në jetën ekonomike, kulturore, sociale dhe politike të vendit në pozita barazie me të gjithë qytetarët e tjerë të Shqipërisë.
- ? Krijimi i nje klase intelektuale romë me qëllim përfaqësimin në mënyrë sa më dinjitoze të këtij komuniteti në shoqëri civile.
- ? Krijimi i nje identiteti të komunitetit rom në të cilin të vlerësohen dhe të vihen në pah vlerat historike dhe kulturore.

2. Fushat në të cilat duhet të veprojë strategjia janë:

- ? Arsimi

- ? Arti dhe Kultura
- ? Mediat.
- ? Pjesëmarrja në jetën civile
- ? Punësimi, Strehimi dhe Çështjet sociale
- ? Rendi publik
- ? Administrata qendrore dhe lokale
- ? Shëndetësia
- ? Drejtësia
- ? Ekonomi

3. Principet bazë të hartimit të strategjisë;

Strategjia duhet të hartohet si rezultat i një pune të përbashket midis Qeverisë dhe përfaqësuesve të komunitetit rom dhe organizatave joqeveritare. Në këtë mënyrë kjo strategji do të ketë element përbërës kërkesat e komunitetit rom si dhe kapacitetet dhe mundësitë reale realizuese të shtetit.

Hartimi i kesaj strategjie do të bëhet në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar si dhe me atë ndërkombëtar i cili është i zbatueshëm në vendin tonë.

Implementimi i kesaj strategjie do të behet duke u bazuar në principin e decentralizimit të pushtetit. Në këtë mënyrë, në të gjitha Prefekturat dhe Bashkitë, ku aktualisht jeton komuniteti rom do të caktohen punonjës të këtyre institucioneve si dhe anëtarë tëkomunitetit rom për të ndjekur dhe zbatuar këtë Strategji.

4. Kjo strategji duhet ti drejtohet shoqerise civile shqiptare dhe në veçanti grupeve të mëposhtme të saj si;

- ? Anëtareve të komunitetit rom me banim në Shqipëri dhe me nënshtetësi shqiptare.
- ? Klasës politike drejtuese
- ? Punonjësve të administrates qendrore dhe lokale
- ? Organeve të shtypit elektronik dhe atij të shkruar.

5. Drejtimet kryesore të veprimit për çdo fushë:

Arsimi

Përgatitja e një programi për të inkurajuar fëmijët rome që të ndjekin shkollën ku të përfshihet dhe puna e asistentëve sociale me prindërit rom.

Përfshirja në programet shkollore të temave që luftojnë çdo lloj diskriminimi.

Bursa studimi për të rinjtë rom të cilët duan të vazhdojnë arsimin e lartë.

Mundësia për të futur në shkollat profesionale egzistuese të degëve artizanale ku romët kanë tradita.

Orientimi i të rinjve rom për të studiuar në shkollat të cilat japin mundësinë për të punuar në administratën publike si psh; Shkencat Sociale, Akademia e Rendit, Akademia Ushtarake, etj...

Përgatitja dhe arsimimi i mësuesve rom.

Arti dhe Kultura

Organizimi i veprimtarive kulturore me qëllim afirmimin e identitetit të tyre si dhe promovimin e aspekteve pozitive tëkultures rome.

Mbështetjen e aktiviteteve kulturore të folklorit rom.

Promovimin dhe krijimin e programeve kulturore dhe informuese për romët në televizionin publik.

Ekonomi

Financimi i projekteve të cilat kanë si qëllim promovimin e produkteve artizanale të prodhuara tradicionalisht nga romët në tregun e shitjes shqiptar dhe të huaj.

Mbështetja e Ndërrmarrjeve të Vogla dhe të Mesme të cilat janë pronë e personave që bëjnë pjesë në komunitetin rom nëpërmjet dhënies së kredive të buta dhe afatgjatë.

Inkurajimi i projekteve të cilat hapin vende pune për pjesëtarët e komunitetit rom veçanërisht për gratë rome.

Uljen e nivelit të papunësisë të romëve nëpërmjet krijimit të politikave lehtësuese fiskale për ato kompani të cilat punësojnë anëtare të komunitetit rom.

Rendi publik

Përfshirja e anëtarëve të komunitetit rom në efektivat e policisë në ato Qarqe ku ata jetojnë në një numër të konsiderueshëm.

Organizimi i seminareve për efektivat e organeve të policisë me temë “Respektimi i të drejtave të njeriut dhe në veçanti ato të minoriteteve”.

Marrja e masave disiplinore kundër atyre punonjësve të policisë të cilët në kryerjen e detyrës diskriminojnë ose keqtrajtojnë persona për faktin se janë romë.

Drejtësia

Përmirësimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe atyre të minoriteteve në veçanti. Kjo mund të përfshihet dhe në kuadrin e angazhimeve që Qeveria Shqiptare ka marrë në procesin e hapjes së negociatave për marrëveshjen e stabilizim-asocimit me BE-në.

Respektimi i të drejtave të njeriut dhe në veçanti të të drejtave të minoriteteve konform Konventave Ndërkombëtare në të cilat vendi ynë aderon.

Punësimi, Strehimi dhe Çështjet sociale

Krijimi i politikave sociale me qëllim zbutjen e varfërisë të familjeve rome brenda mundësive egzistuese të shtetit shqiptar.

Mbështetja e të rinjve romë të cilët mbarojnë shkollën për t`u futur në tregun e punës.

Dhënia me prioritet e asistencës sociale të familjeve rome që pëmbushin kushtet e parashikuara nga ligji për përfitimin e kësaj asistence.

Shëndetësia

Planifikimi familjar.

Asistencë në medikamente mjekësore për familjet rome.

Theksojmë se të gjitha sugjerimet e dhëna më sipër janë të diskutueshme dhe në kompetencë të plotë të specialistëve të institucioneve të lartpërmendura.

Lidhur me paragrafin 32, përsa i përket rolit të Avokatit të Popullit në identifikimin dhe në luftën kundër diskriminimit, theksojmë se parandalimi i diskriminimit dhe mbrojtja e të drejtave të minoriteteve janë të lidhura midis tyre. Harmonia në marrëdhëniet ndërmjet pakicave dhe pjesës tjetër të popullsisë dhe respektimi i identitetit të tyre përbëjnë një aset të madh në diversitetin multi-etnik dhe multi-kulturor të shoqërisë sonë. Në këtë kuptim është shumë i rëndësishëm procesi i

ndërgjegjësimit qytetar me të drejtat e njeriut, me njohjen e “diskriminimit” si fenomen. Gjithsesi mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim. Megjithëse në bazë të ligjit, Avokati i Popullit nuk ka fuqi vendimmarrëse në raport me organet e administratës, por vetëm të drejtën e rekomandimeve përkatëse, kjo nuk do të thotë se ky institucion nuk ka mjete për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e individëve. E drejta që ka ky institucion për t’i ndjekur çështjet shkallë-shkallë sipas hierarkisë së administratës deri në dërgimin e çështjes në Kuvend, si dhe transparenca, bashkëpunimi me OJQ-të dhe Median, përbëjnë element të rëndësishëm për realizimin e detyrave të tij.

Lidhur me sugjerimin e Komitetit Këshillues, për shtrirjen e aktivitetit të Institucionit të Avokatit të Popullit edhe në jug të Shqipërisë, sqarojmë se ky institucion ka kompetencë të ushtrojë aktivitetin e tij në gjithë territorin e Shqipërisë dhe në këtë kontekst, kriteri gjeografik nuk përbën kufizim. Gjithashtu po shihet mundësia për financimin nga buxheti i shtetit i veprimtarisë së këtij institucioni konkretisht në caktimin e një përfaqësuesi në Gjirokastrë dhe një në Shkodër.

NENI 5

Lidhur me paragrafin 34, përsa i përket mbështetjes më të madhe nga ana e autoriteteve shtetërore shqiptare për financimin e një sërë projektesh të paraqitura nga anëtarët e pakicave theksojmë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, mbështet aktivitetet e ndryshme të pakicave për të ruajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre, duke financuar projektet e paraqitura me iniciativën e tyre dhe aktivitetet e organizuara nga Qendra ndërkombëtare e Folkut. Në këtë kuadër Qeveria e Shqipërisë dhe në mënyrë të veçantë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve shpreh angazhimin e saj se gjatë këtij viti do të ketë një vëmendje më të madhe ndaj zhvillimit kulturor të identitetit të pakicave, duke ndjekur një politikë favorizuese në financimin e projekteve të ndryshme për këtë qëllim.

Paragrafi 35. Përsa i përket shqetësimit të Komitetit Këshillues për asimilimin e vllahëve/arumunëve në Shqipëri, ekspertët duhet të kenë parasysh se ky proces integrimi nuk është dukuri e sotme, por rezultat i një procesi të gjatë historik dhe se nuk mund të rikthehet artificialisht gjëndja e kaluar. Kjo nuk do të thotë që mos merren parasysh veçoritë e atij komuniteti vllahësh që i ka ruajtur ende tiparet e veta gjuhësore, kulturore etj. Shteti shqiptar pa dyshim duhet të marrë masa dhe të inkurajojë ruajtjen e këtyre tipareve. Qeveria shqiptare nuk e ka të lehtë të realizojë rikthimin e proceseve historike asimiluese të ndodhura në shekuj, por megjithatë mbështet elementët e mbetura të identitetit gjuhësor të tyre., p.sh ministria e kulturës në bazë të rekomandimit 1333 të Asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës mbështet aktivitetet e disa grupeve folku të arumunëve në qytetin e Korçës. Aktualisht atyre u janë krijuar kushtet për ta mësuar këtë gjuhë dhe për t’i zhvilluar të gjitha elementët e identitetit të tyre kulturor. Gjithashtu kanë shoqatën e tyre “Shoqata e arumunëve”, dhe organizojnë herë pas here aktivitete të ndryshme në

gjuhën e tyre me qëllim jehonën e vlerave dhe zakoneve të tyre. Gjithashtu, ata kanë një shkollë në Divjakë, ku programi mësimor zhvillohet në gjuhën vllehe.

Mirëpo nga ana tjetër, prej rradhëve të vllehëve, në Shqipëri kanë dalë personalitete të shquara në të gjitha fushat e kulturës dhe të artit. Ata i kanë kryer veprat e tyre në gjuhën shqipe dhe marrin pjesë në mënyrë aktive në fushat më të ndryshme të jetës shoqërore.

NENI 6

Paragrafi 36-38 Qeveria shpreh vlerësimet për konstatimet e Komitetit Këshillues për frymën e tolerancës që mbizotëron përgjithësisht në Shqipëri dhe shpreh angazhimin e saj në eliminimin e çdo lloj forme paragjykimi apo diskriminimi lidhur me komunitetin rom. Çështja e statusit të tij është një çështje që duhet zgjidhur duke parë edhe legjislacionin e vendeve të tjera, por pavarësisht nga statusi i ardhshëm i tyre duhen marrë masa të mëtejshme bazuar në mundësitë konkrete të shtetit. Gjithashtu, Institucioni i Avokatit të Popullit i kushton rëndësi të veçantë kontakteve me ankuesit, pasi ai është krijuar për të ndihmuar në zgjidhjen e nevojave të individëve, të parandalojë dhe të zbulojë shkeljen e të drejtave dhe lirive të individit. Problematika e ankesave të ardhura nga individët që i përkasin pakicave, nuk ka qënë e lidhur me diskriminimin apo përkatësinë etnike.

Autoritet shqiptare do të konsiderojnë me kujdes tendencat paragjyquese lidhur me këto komunitete, sidomos në media. Zyra e Minoriteteve në këtë kuadër është gjithmonë e vëmendshme ndaj pasqyrimin dhe qëndrimit të shtypit të shkruar dhe elektronik, sidomos lidhur me komunitetin rom. (Ky koment i referohet edhe paragrafit 51, neni 9).

Paragrafi 39 përsa i përket një numri incidentesh dhe keqtrajtimit të minoritetit grek gjatë zgjedhjeve lokale në Himarë. Qeveria Shqiptare vë re se çështja e zgjedhjeve elektorale në Himarë është një problem që i përket të shkuarës, por shpreh edhe një herë keqardhjen për keqpërdorimin e pakicave në çdo situatë elektorale, si dhe për frymën e tensioneve dhe retorikës nacionale.

Paragrafi 40 Përsa i përket masave të marra nga qeveria shqiptare për inkurajimin e frymës dhe tolerancës, ndaj pakicës rome, përmendim faktin se ka filluar një veprimtari gjithëpërfshirës si në planin institucional (organizimi i tryezave të rrumbullakta), ashtu edhe në atë të ndihmës konkrete. Gjatë vitit 2002-2003 janë organizuar në bashkëpunim me institucionet ndërkomëtare si dhe shoqatat joqeveritare, seminare të ndryshme për këtë qëllim, përmendim seminarin “Media dhe Minoritetet”, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Arsimit seminary “Edukimi mbi të Drejtat e Njeriut”, nëntor 2002, organizimin në janar 2003 të tryezës së rrumbullakët “Mbi hartimin e politikave mbi romët me fokus mbrojtjen e të drejtave të fëmijve në një shoqëri shumë-kulturore”.

Lidhur me rastet e keqtrajtimit nga organet e policisë të personave të pakicave theksojmë fillimisht se këto janë raste sporadike dhe ky problem egiston jo mbi baza të përkatësisë etnike. Tejkallimet e kompetencave nga organet policore dhe abuzimet

në sistemin e drejtësisë përbëjnë një shqetësim aktual dhe nuk prekin vetëm personat e pakicave. Ato janë pjesë e një procesi të vështirë të ndërtimit të një shoqërie me norma dhe standarde bashkohore dhe demokratike.

Paragrafi 41 Përsa i përket problemit të trafikimit të vajzave rome, theksojmë se ky trafikim bëhet në kuadrin e trafikimit e përgjithshëm të qënieve njerëzore dhe nuk bëhet në bazë të grupimeve etnike apo racore për të cilën Qeveria shqiptare ka një strategji të veçantë lidhur me luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore.

NENI 8

Paragrafi 43 Lidhur me vështirësitë që hasin anëtarët e pakicave për kthimin e pronave, si dhe marrjen e masave të kujdesshme nga qeveria, në mënyrë që ky proces të realizohet pa asnjë lloj forme diskriminimi, mendojmë se një pretendim i tillë nuk qëndron dhe se për këtë çështje nuk ka ndonjë diskriminim për personat që u përkasin pakicave, por vështirësitë dhe problemet e hasura në këtë proces janë për të gjithë kategoritë e popullsisë. Shteti shqiptar ka krijuar dhe në vazhdimësi po krijon mundësitë dhe hapësirat e duhura ligjore, përsa i përket të drejtës së pronës për të gjithë popullsinë përfshirë edhe pakicat, brenda territorit të Shqipërisë. Aktualisht në zbatim të detyrimit kushtetues të parashikuar nga neni 181/1 i Kushtetutës së Shqipërisë, është përfunduar projektligji mbi kthimin dhe kompesimin e pronave, i cili do të kalojë në parlament.

Miratimi i Projektligjit për Kthimin dhe Kompesimin e Pronave do të përbëjë një hap të rëndësishëm në procesin e reformave legjislativë lidhur me pakicat.

NENI 9

Paragrafi 46 Përsa i përket ndihmës së shtetit lidhur me mbështetjen e medias së shkruar mendojmë si të rëndësishëm marrjen parasysh të mundësive të kufizuara ekonomike të shtetit shqiptar. Në nivelin e kufizuar të përhapjes së medias së shkruar në gjuhët e pakicave duhet të merret në konsideratë edhe faktori subjektiv, pra dëshira e vetë pakicave, për të shprehur dhe zhvilluar identitetin e tyre kombëtar. Gjithashtu duhet pasur parasysh një raport i drejtë midis popullsisë që i përket pakicave si dhe përhapjes dhe sasisë së botimeve për to, duke nënvizuar se konsumizmi mbizotëron në vetë konceptin e medias.

Paragrafi 47-50 Duke iu referuar komenteve të Komitetit lidhur me zgjerimin e programeve televizive për minoritetet dhe rritjen e nivelit të mbulimit të problemeve të minoriteteve, autoritetet shqiptare duke pasur parasysh dhe nevojat dhe specifikat e pakicave po shqyrtojnë mundësitë e mbështetjes dhe subvencionimit të disa iniciativave lidhur me rritjen e minutazhit të transmetimit të programeve televizive dhe radiofonike lidhur me pakicat, por kjo gjithmonë duke iu referuar mediave publike. Parimi i lirisë dhe pavarësisë së shtypit bën që mundësia e shtetit për të ndërhyrë në rritjen e programacionit televiziv dhe radiofonik të jetë shumë e kufizuar lidhur me median private. Ai ushtron aktivitetin e tij në bazë të fuqisë financiare të subjektit që e financon dhe se autoritetet shtetërore nuk mund të ndërhyjnë për një

mbështetje të asnjë lloj forme duke respektuar pavarësinë e subjekteve në fjalë. Problemet financiare janë të përgjithshme për gjithë shtetasit shqiptar pa dallim feje, kombësie etj dhe ky është shkaku i aksesit të kufizuar.

Lidhur me mungesën e kërkesave për licensa, nga ana e pakicave kombëtare Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në gusht 2002, ka licensuar subjektin “Radio Prespa”, që transmeton programe në gjuhën e pakicave maqedonase, si dhe ka patur interesim për hapjen e një stacioni me përsëritës nga komuniteti malazez. Gjithashtu janë paraqitur kërkesa nga përfaqësues të pakicës kombëtare greke për ritransmetim me përsëritës dhe transmetim radio vendore.

NENI 10

Paragrafi 52-53 Qeveria e Republikës së Shqipërisë e konsideron të drejtën e përdorimit të gjuhës së pakicave në zonat tradicionalisht të banuara prej tyre, si një aspekt shumë të rëndësishëm të mbrojtjes dhe promovimit të vlerave të tyre etniko-kulturore. Në zonat ku janë të pranishme pakicat kombëtare, gjuha e tyre mund të përdoret lirisht me autoritetet e pushtetit vendor që i përkasin këtyre pakicave, por duke pasur parasysh përqindjen e popullsisë që i përket pakicave në raport me popullsinë vendase, në komunikimin me autoritetet e tjera vendore dhe qendrore përdoret gjuha shqipe. Gjithashtu, aktet dhe dokumentat e tjera zyrtare, formulohen dhe shpallen në shqip, si e vetmja gjuhë zyrtare e njohur.

Theksojmë se është e rëndësishme që pas një vlerësimi të nevojave të përdorimit të gjuhës së pakicave në ato zona ku ato banojnë tradicionalisht apo janë në një numër të konsiderueshëm, të merren masat e përshtatshme për plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, duke përfshirë këtu dhe përcaktimin e kriterëve të qarta për emërtimin e rrugëve dhe treguesve të tjerë topografikë.

NENI 11

Paragrafi 54-55 Përsa i përket ankesave nga anëtarët e pakicës malazeze të cilëve u është kërkuar të vënë emra shqiptarë dhe nuk kanë pasur mundësi që t'i ndryshojnë emrat e tyre në formën e tyre tradicionale, shprehemi se nuk jemi vënë në dijeni të rasteve konkrete të sipërpërmendura. Personat e pakicave kanë të drejtë të përdorin emrat dhe mbiemrat e tyre sipas traditës në gjuhën amtare. Ata nuk janë privuar nga kjo e drejtë, por është fakt se shumë shqiptarë, jo vetëm të fesë ortodokse, por edhe të asaj myslimane janë regjistruar pranë Zyrave të Gjëndjes Civile me emra dhe mbiemra grek. Organet e qeverisjes vendore kanë mirëpritur çdo kërkesë për ndryshim emri në zonat e tyre dhe kjo ka gjetur zgjidhjen e përshtatshme.

Neni 12

Paragrafi 57 Lidhur me rishikimin e kurikulave dhe teksteve të reja shkollore me qëllim përmirësimin e nivelit arsimor si dhe heqjen e stereotipeve negative për pakicat kombëtare, nga materialet shkollore, nënvizojmë se në grupet e punës për rishikimin e kurikulave dhe teksteve shkollore ka ngënë si praktikë dhe do të jetë pjesëmarrja e autorëve, që u përkasin pakicave.

Paragrafi 58 Përsa i përket trajnimit të mësuesve, është menduar jo vetëm për trajnimin e mësuesve të pakicave kombëtare në shërbim, por edhe për një formim cilësor të tyre në fakultetet që përgatisin mësues. Deri tani janë kryer kualifikime të kuadrit mësimor që shërben në shkollat e pakicave kombëtare. Këto kualifikime do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, në bashkëpunim me shtetet të cilat u përkasin pakicat. Në këtë kuadër gjuhojmë si të rëndësishme, krijimin e mundësive për trajnimin dhe të mësuesve që u përkasin pakicave të tjera.

Paragrafi 59

Përsa i përket vështirësive të fëmijëve romë në ndjekjen e programit mësimor për shkak të distancës së largët, të ardhurave të ulta, theksojmë se autoritetet shtetërore po shohin me seriozitetin e duhur çështjen e arsimit të romëve. Megjithatë duhet të jemi të ndërgjegjshëm se problemet në arsimimin e romëve në shumë raste shkaktohen nga mënyra e tyre e të jetuarit, qëndrimi i tyre ndaj sistemit, ligjit dhe së drejtës, mungesa e predispozicionit të tyre ndaj arsimit. Shprehje e përpjekjeve konkrete, është angazhimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në hartimin e një strategjie të veçantë për arsimimin e tyre.

Paragrafi 60

Lidhur me masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e kushteve të arsimit të romëve, theksojmë se do të bëhen përpjekje të mëtejshme për formimin e mësuesve të pakicave romë si dhe për kualifikimin e mësuesve romë në shërbim. Gjithashtu do të caktohen mësues të përgatitur për të dhënë gjuhën shqipe në shkollat me fëmijë romë, me qëllim që të rritet përvetësimi cilësor i gjuhës shqipe. Kjo gjë do të bëhet edhe për pakicat e tjera.

Në këtë drejtim përmendim rëndësinë potenciale të strategjisë kombëtare për romët që po hartohet, e cila do të jetë pjesë përbërëse e Strategjisë kombëtare për “Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Romëve”

Paragrafi 61. Lidhur me shtrirjen e sistemit arsimor në të gjitha hallkat e tij duke përfshirë edhe arsimin e lartë, do të shqyrtohet mundësia e motivimit të fëmijëve të minoriteteve të tjera, përveç atij grek, me qëllim që të rritet niveli i arsimit të tyre deri në atë universitar, sidomos për degën e mësuesisë.

NENI 14

Paragrafi 65. Përsa i përket “zërave” për hapjen e shkollave të tjera për fëmijët grek, jashtë atyre zonave që quhen “zona minoritare” duke iu referuar p.sh. kërkesës për hapjen e klasave në greqisht në Himarë, theksojmë se Qeveria Shqiptare në trajtimin e kërkesave [për hapjen e shkollave publike në gjuhën e pakicave do të bazohet gjithmonë në ligjet aktuale për arsimin, si dhe në parimet e Konventës Kuadër. Vendimi për hapjen e një shkolle publike në Himarë duhet bërë konform legjislacionit aktual shqiptar (V.K.M, Nr. 396, date 22.08.1994, “Për arsimin 8-vjeçar në gjuhën amtare të personave të pakicave”), i cili është në përputhje të plotë me parametrat e Konventës Kuadër (si dhe në koherencë të plotë me mendimin e ekspertëve të Këshillit të Evropës). Në këtë kuadër nga shqyrtimi i kërkesës për hapjen e shkollës nga rregjistrat e gjëndjes civile të qytetit të Himarës rezulton se të 34 prindërit që kanë bërë këtë kërkesë janë me kombësi shqiptare dhe për këtë arsye nuk është e mundur hapja e një shkolle të tillë.

Duke patur parasysh rëndësinë e çështjes me ndërmjetësimin e Zyrës së Minoriteteve është organizuar në Ministrinë e Arsimit një takim me drejtuesit e Omonia-s, të Himarës dhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Arsimit të Mesëm dhe Tetëvjeçar, ku

përveç paraqitjes së motiveve të moshapjes së një shkollë të tillë, përfaqësuesve të minoritetit grek. u janë ofruar dhe dy alternativa për zgjidhjen e kësaj çështje;

? Alternativa e parë: Kapërcimi i vështirësive burokratike për hapjen e një shkolle private, duke përdorur një procedurë të përsheptuar.

? Alternativa e dytë: Mundësia e zhvillimit në shkollën publike të Himarës për ata që dëshirojnë, të lëndëve të historisë dhe gjuhës greke, në greqisht. (lëndë komplementare).

Asnjë nga alternativat nuk u pranua nga përfaqësuesit e minoritetit grek duke mos e argumentuar këtë mospranim. Nga ana e autoriteteve shtetërore shqiptare egziston vullneti për zhvillimin në shkollën publike të Himarës për ata që dëshirojnë, të lëndëve të historisë dhe gjuhës greke si lëndë komplementare.

NENI 15

Paragrafi 67-69

Lidhur me shqetësimin e komitetit për egzistencën dhe për rikrijimin e postit të Ministrit për Minoritetet Kombëtare nënvizojmë se në bazë të ligjit për Funkcionimin e Këshillit të Ministrave, gjykohet që në përbërjen e qeverisë të mos ketë një Ministër shteti, i cili të ketë si detyrë respektimin e të drejtave të njeriut, ku brenda këtij kuadri siç dihet bën pjesë edhe respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave kombëtare. Lidhur me forcimin e mëtejshëm të strukturave që janë brenda ministrive dhe nivelit lokal që trajtojnë çështjet e minoriteteve së fundi Ministria e Arsimit dhe Shkencës po

konsideron krijimin e një seksioni të veçantë që do të ketë si detyrë ndjekjen e problemeve që shtrohen në fushën e arsimit të minoriteteve. Megjithatë me konsolidimin e Zyrës së minoriteteve egzistojnë të gjitha mundësitë për të ndjekur nga afër problemet e pakicave brenda vendit, si dhe realizimin e kontakteve me organizmat përkatëse ndërkombëtare, lidhur me çështjen e minoriteteve.

Paragrafi 69. Lidhur me kuadrin e kufizuar të zhvillimit të dialogut midis autoriteteve shtetërore dhe pakicave theksojmë se Qeveria Shqiptare, nëpërmjet strukturave ekzistuese po ndërton bazat e një dialogu institucional dhe konstruktiv me pakicat.

Paragrafi 70-73 Duke iu referuar komenteve lidhur me nivelin politik të përfaqësimit si atij qëndror dhe lokal dhe sistemin zgjedhor, vemë në dukje se, PBDNJ-ja asnjëherë nuk e ka përkufizuar veten si parti e pakicës greke, kështu që nuk mund të thuhet se pakicave të tjera kombëtare iu është kufizuar mundësia e përfaqësimit në kuvend qoftë nëpërmjet PBDNJ-së, apo edhe si kandidatë të pavarur. Përsa i përket nivelit të përfaqësimit në pushtetin vendor mund të themi se minoriteti grek ka përfaqësues të tij në të gjitha nivelet e pushtetit të zgjedhur. Ata janë në krye të komunave përkatësisht tetë anëtar të minoritetit grek nga të cilët tre në gjirokastër, tre në Sarandë dhe dy në delvinë. Gjithashtu janë rreth 160 këshilltarë, anëtarë të minoritetit grek në nivele të këshillave komunave dhe bashkive të zgjedhur në bazë të kodit elektoral. Lidhur me pakicën maqedonase e cila ndodhet e

përqëndruar në komunën e Liqenasit, përfaqësimi në qeverisjen vendore është tërësisht nga komuniteti i minoritetit.

Lidhur me përfaqësimin e drejtëpërdrejtë të pakicave në parlament, pavarësisht nga numri i tyre, duhet pasur parasysh se favorizimi i pakicave fare të vogla nga njëra anë është një masë që nxit forcimin e rolit të tyre respektimin e të drejtave të tyre, por nga ana tjetër mund të përbëjë një shkelje e parimit të barazisë së shtetasve dhe krijon mundësi artificiale që në rast të balancimit numerik të forcave politike kryesore të përfaqësuara në parlament, pak vota që u përkasin grupeve të vogla të pakicave, të peshojnë në mënyrë vendimtare dhe të padrejtë, në shpërpjestim me peshën e tyre reale në jetën politike.

Kur bëhet fjalë për përfaqësimin e elementit minoritar në parlament duhet përmendur fakti se një numër personash që u përkasin minoriteteve përfaqësojnë në Parlament parti të tjera politike. Ka patur gjithmonë një mesatare 5-10 persona që u përkasin pakicave (sidomos atij grek) të cilat janë zgjedhur në parlament në listat e partive të tjera. Në Parlament ka një komision të posaçëm për të drejta e njeriut dhe minoriteteve, i cili është drejtuar nga një përfaqësues i partisë “PBDNJ”-së. Sigurisht që rishikimi i ligjit zgjedhor dhe roli i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve do të ndikojë në përmirësimin e kësaj situatë.

Paragrafi 75-76 Lidhur me pjesëmarrjen e ulët të pakicave në jetën publike dhe ekonomike theksojmë se të gjitha zonat ku jetojnë pakicat kanë liri të plotë komunikimi me Greqinë dhe afërsia me të u krijon shumë lehtësira. Shumica e tyre punon në Greqi, dhe në këto zona aktiviteti tregtar ka një zhvillim të dukshëm, gjë që bën që ndonjëherë situata ekonomike e tyre të jetë më e mirë se pjesa tjetër e popullsisë vendase. Anëtarët e këtij minoriteti janë ndër më aktivët e veprimtarisë prodhuese dhe tregtare në vend dhe japin kontributin e tyre në ekonominë e vendit. Në rrethin e gjirokastrës, 65% e të ardhurave për buxhetin vendor sigurohen nga veprimtaria ekonomike e biznesit të anëtarëve të minoritetit grek. Bashkimi i tyre me faktorin shqiptar është i admirueshëm. Në zonën e Dropullit janë rreth 120 firma private, pronë e pakicave greke. Disa nga këto firma e kanë shtrirë veprimtarinë e tyre dhe janë të njohura në të gjithë vendin. Këta tregues janë dëshmi e tolerancës që është baza e bashkëjetesës normale dhe miqësore midis pakicës dhe shumicës. Në çdo komunë ku drejtojnë minoritarë, financimet për mbajtjen e administratës dhe sigurimeve shoqërore jepen në përputhje me legjislacionin përkatës. Investimet në këto zona janë në përputhje me gjendjen dhe planet e zhvillimit të tyre.

Megjithatë një analizë përsa i përket niveleve të pjesëmarrjes efektive të pakicave, në jetën ekonomike dhe shërbimet publike ndoshta do të çonte në konkluzionin se më shumë duhet bërë përsa i përket personave që u përkasin pakicave të tjera në Shqipëri.

Gjithashtu duhet të kihet parasysh se në kushtet ekonomike të shtetit shqiptar, mekanizmat e ndërhyrjes favorizuese ekonomike dhe sociale të shtetit janë të kufizuara dhe ndikojnë te të gjithë shtetasit shqiptarë, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.

Paragrafi 78 duke ju referuar komenteve mbi lehtësimin e regjimit të vizave me fqinjët, theksojmë se po punohet vazhdimisht në këtë drejtim për të gjithë shtetasit shqiptar, duke përfshirë dhe pjesëtarët e pakicave. Në këtë kuadër përmendim se pjesëtarët e minoritetit grek dhe maqedonas janë të favorizuar nga qeveritë përkatëse për dhënien e vizave me një afat kohor deri në 5 vjet, për pensionet, shërbimet shëndetësor falas, të drejtat e studimit, trajtimi i veçantë për mësuesit minoriatrë etj, ndërkohë që pjesa tjetër e popullsisë shqiptare, përfshi këtu romët dhe egjiptianët, nuk e kanë këtë të drejtë favorizimi.

Paragrafi 79 Duke qënë të ndërgjegjshëm se nënshkrimi i Marrëveshjeve është një instrument i rëndësishëm në kuadrin e mbrojtjes së të drejtave të pakicave autoritetet shqiptare kohët e fundit po konsiderojnë mundësinë e nënshkrimit të një Marrëveshje me Republikën Federale të Jugosllavisë. Këto Marrëveshje të cilat Shqipëria i ka nënshkruar me Greqinë dhe Maqedoninë sigurisht do të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të mbrojtjes së të drejtave të pakicave, si dhe në forcimin e bashkëpunimit rajonal si një nga elementët themelore të Proçesit të Stabilizim-Asociimit me BE-në.